



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.29 datë 27.07.2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.01,
DATË 06.11.2018 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“TIRANA RESIDENTIAL & BUSINESS PARK PËR NJË ZONË TË RE ME PËRDORIM
MIKS NË TIRANA BUSINESS PARK, RRUGA E RINASIT, ME VENDNDODHJE
BASHKIA VORË”,

Në mbështetje të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Tirana Business Park” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave që përmendet në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.01, datë 06.11.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Tirana Residential & Business Park për një zonë të re me përdorim miks në Tirana Business Park, Rruga e Rinasit, Bashkia Vorë”, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR I SEKRETARIT KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

